



**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**  
**DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHENIEVE ME JASHTË**

Nr. 307 Prot.

Tiranë, më 07/04/2015

**Lënda:** Dërgohen komentet lidhur me kërkesën Tuaj me Nr. 19 Akti, datë 13.03.2015.

**Drejtuar:** **GJYKATËS KUSHTETUESE**

**T I R A N Ë**

Të nderuar Gjyqtarë!

Në përgjigje të shkresës me nr. 19 Akti të datës 13.03.2015, me anë të së cilës kërkohen komente lidhur me shqyrtimin e kërkesës së Gjykatës së Lartë, me objekt: “*Shfuqizimi i nenit 113 të Kodit Penal si nen që vjen në kundërshtim me Kushtetutën*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron sa më poshtë vijon qëndrimin e tij lidhur me çështjen objekt shqyrtimi:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në vitin 2012 i ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë një rekomandim për: “*shfuqizimin e nenit 113 të Kodit Penal me qëllim që viktimat e trafikimit të mos bëhen subjekte të ndjekjes penale dhe ndëshkimit*”. Ky qëndrim i KMD, u bazua jo vetëm në analizën e legjislativit, por edhe në raportet e organizatave ndërkombëtare. Veçanërisht KMD u mbështet në konkluzionet përfundimtare që ka dhënë Komiteti i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Eleminimin e Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në lidhje me raportimin e III-të periodik të Shqipërisë në 26 Korrik 2010, ku ndër të tjera, shprehët se: “*Komiteti përsërit shqetësimin e tij, të përfshirë dhe në vëzhgimet e mëparshme përfundimtare, se prostitutat dhe viktimat e trafikimit kanë ngel ende subjekt që dënohen sipas nenin 113 të Kodit Penal*”.



Adresa: Rroga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Shqipëria, ka aderuar që prej vitit 1993 në Konventën e OKB-së "Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave". Në nenin 6 të saj, Konventa CEDAW parashikon se: "Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, përluftimin e të gjitha formave të trafikut të grave dhe të shfrytëzimit për prostitucion të grave". Shqipëria ashtu si vendet e tjera anëtarë raporton pranë CEDAW, mbi zbatimin e Konventës "Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" dhe Komiteti CEDAW është organi kompetent që mund të bëjë interpretimin përfundimtar të Konventës "Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave". Bazuar në neni 116 dhe 122/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj nga Republika e Shqipërisë, kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit të cilat nuk pajtohen me to.

Në rekomandimin dërguar Kuvendit, KMD, theksoi se, neni 113 i Kodit Penal, një dispozitë ligjore e cila në dukje është e paanshme, vendos grupin e grave dhe të vajzave në kushte jo të favorshme për shkak të gjinisë së tyre, në raport me personat që përfitojnë marrëdhënie seksuale në mënyrë të paligjshme apo personat që mund të përfitojnë në mënyra të ndryshme, nga ushtrimi i prostitucionit, të cilët edhe pse me veprimet e tyre konsumojnë elementë të veprës penale të parashikuar nga neni 113 i Kodit Penal, nuk ndëshkohen. Pra, efekti i kësaj dispozite ishte i ndryshëm për këto dy grupe personash dhe konkretisht i vendos gratë dhe vajzat nën një trajtim më pak të favorshëm.

Në ndryshimet që Kuvendi i Shqipërisë i bëri Kodit Penal me ligjin nr. 23/2012, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nuk e shfuqizoi neni 113, por këtij neni i shtoi një paragraf të dytë, nëpërmjet të cilit ndëshkohej edhe personi i cili ofronte shpërbirim përfitim personal të prostitucionit. Në gjykimin tonë edhe ky ndryshim që i është bërë nenit 113 të Kodit Penal nuk e zgjidh çështjen e mosdiskriminimit të grave dhe vajzave. Me ndryshimet e bëra në vitin 2012, parografi i parë i nenit 113 të Kodit Penal mbeti i pandyshuar dhe përbën ende rrezik që vajzat dhe gratë viktima të trafikimit apo shfrytëzimit të prostitucionit të dënohen.

Ashtu siç është shprehur edhe Gjykata e Lartë, ushtrimi i prostitucionit është ngushtësisht i lidhur me shfrytëzin e prostitucionit dhe trafikimin e grave. Ne do të shtonim se në mjaft raste dhe me qëllim që shfrytëzuesit dhe trafikantët t'i shpëtojnë dënimit rastet e shfrytëzimit të prostitucionit apo trafikimit manipulohen dhe paraqiten sikur janë ushtrimi prostitucioni. Neni 113 jo vetëm që që sjell pasoja diskriminuese përvajzat dhe gratë, por ai mund të shërbejë si rrugë shpëtimi për trafikantët dhe shfrytëzuesit.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

Është botërisht e pranuar dhe gjerësish trajtohet si problematikë që kërkon vëmendje dhe angazhim nga ana e shteteve, se shumica e individëve që ushtrojnë prostitucion janë gratë dhe vajzat, ndërkoqë që shumica e përfituesve janë meshkuj. Në këtë mënyrë me ndryshimin që i është bërë nenit 113, edhe pse në pamje të parë ky ndryshim ka synuar barazinë formale lidhur me gjininë subjektit, faktet tregojnë se janë gratë dhe vajzat ato që janë në masë të madhe subjekte të ndjekjes penale për këtë vepër penale. Madje mënyra se si është ndryshuar nenii 113 i Kodit Penal, duke bërë subjekt të ndjekjes penale edhe personin i cili ofron shpërbirim për përfitim personal të prostitucionit, mund të bëjë që në mënyrë fiktive kjo dispozitë të mos zbatohet, kjo përfaktin se ofruesit e shpërbimit (klientët) për t'i shpëtuar ndjekjes penale mund t'a detyrojnë personin që ushtron prostitucion që ta paraqesin situatën përparrë organit të ndjekjes penale jo si një marrëdhënie prostitacioni, por si një lidhje dashurore.

Nenii 113 i Kodit Penal, është është një figurë e veprës penale, e cila është e parashikuar nga Seksioni VIII, Kodit Penal, ku parashikohen vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit. Në këtë seksion të gjitha veprat penale të parashikuara synojnë të mbrojnë "moralin publik". Koncepti i moralit, ashtu siç shprehet edhe Gjykata e Lartë, është në vetvetë një koncept i vështirë për tu përkufizuar dhe subjekt i ndryshimit ndër vite. Nga ana tjetër koncepti i moralit ndryshon edhe nga një shoqëri në tjetrën. Në luftën kundër diskriminimit dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, morali, zakonet apo traditat në asnjë rast nuk mund të shërbejnë si justifikim i ligjshëm dhe objektiv për shkeljen e të drejtave.

Duke u bazuar në sa më sipër, qëndrimi i KMD është se nenii 113 i Kodit Penal, vjen në kundërshtim me Konventën CEDAW dhe me nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pasi ai diskriminon gratë dhe vajzat për shkak të gjinisë dhe si i tillë ai duhet të shfuqizohet.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)